



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbal i mbajtur më 25 qershor 2015, në mbledhjen e XVIII-të
(tetëmbëdhjetë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.05’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht Afrim Shabani, Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekalju, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE – së.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa më 29 maj 2015

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Korniza Afatmesme Buxhetore 2016 – 2018

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Haki Rudari, theksoi, për Grupin e këshilltarëve të LVV – së dhe për mua personalisht, ky dokument është i një rëndësie të veçantë si në aspektin ligjor ashtu edhe në aspektin e praktikës së përgjithshme ngase jam i mendimit që përmes mekanizmave dhe menaxhimit më të mirë kjo ndikon drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve të Komunës tonë.

Te Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, për hartimin e projekteve janë paraparë 30.000 €, lidhur me këtë shtroj pyetje, përse për disa projekte qytetarët po obligohen të bëjnë dhe paguajnë projektet zbatuese ndërsa në këtë dokument figuron shuma e cekur për hartimin e projekteve, andaj do duhej të jepet një arsytim ngase nuk është mirë të bëhet dallimi në mes të qytetarëve. Sa i përket pastrimit të lumit Llap, është projekt të cilin e mbështes, mirëpo në të njëjtën kohë e kemi ndërtimin e kanalizimit në fshatin Siboc nga i cili ujërat e zeza derdhen në Llap, pra njëri projekt e përjashton të tjetrin.

Për asfaltimin e rrugëve në qytet janë paraparë 737.888 €, është projekt i qëlluar mirëpo qytetarët janë kureshtar dhe po pyesin se rrugët e cilave lagje do të asfaltohen, andaj do të ishte mirë kjo çështje të specifikohet. E njëjta çështje është edhe te fshatrat po e zëmë, asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Shajkoc.

Te Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, për ndërtimin e trotuareve janë paraparë 80.000 €, mirëpo nuk specifikohet dhe nuk sqarohet se në cilat rrugë do të rregullohen trotuaret, edhe pse në vazhdimësi të gjithë jemi pajtuar që trotuaret të ndërtohen afër shkollave në rrugët magjistrale të cilat janë me prioritet, ndoshta janë paraparë edhe vendet e cekura por në këtë dokument nuk po figuron.

Zgjerimi dhe pastrimi i shtretërve të lumenjve në fshatra, është projekt i qëlluar por në të njëjtën kohë kemi ndotjen e lumenjve.

Riparimi dhe ndërtimi i urave, edhe në këtë rast mungon specifikimi në mënyrë që të sqarohet se cilat ura janë të parapara për riparim apo ndërtim.

Te Drejtoria e Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, për ngritjen e serave janë paraparë nga 150 € për përfitues, plotësisht e mbështesë këtë, por në të njëjtën kohë kemi një ndarje jo të mirë në këtë drejtim, për këtë ne kemi propozuar që në Kuvend të ngritet një Komitet i bujqësisë i cili sado pak të inkorporohej në këtë drejtim.

Te Drejtoria e Arsimit, është propozuar projekti për zgjerimin dhe renovimin e objekteve shkollore në shumë prej 130.000 €, mirëpo edhe në këtë rast nuk specifikohet se ku do të kryhen punimet përkatëse, për këtë mund të them se gjatë vizitave në terren shpesh qytetarët më pyesin se për cilat shkolla është fjala.

Te Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, ndërtimi i Qendrës së kulturës, në shumë 190.000 €, projekt i cili është bërë si ura e shenjtë ngase disa herë mjetet janë paraparë për këtë projekt e pastaj ato mjete janë ridestinuuar në projekte të tjera, andaj do duhej që të specifikohet se kur do të ndërtohet objekti i cekur.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, lidhur me këtë dokument Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur debat me qytetarë në të cilin janë shtruar 21 kërkesa për projekte të ndryshme, të cilat ne Grupi i këshilltarëve i PDK – së i konsiderojmë kërkesa zyrtare dhe pyetja ime ka të bëjë me atë se a është përfshirë ndonjë prej atyre kërkesave për periudhën e ardhshme trevjeçare, meqë jam i mendimit se qytetarët i kanë bërë kërkesat mbi bazën e nevojave ngase sikur të mos kishin nevojë nuk do të vinin fare në atë takim.

Përshtypje më ka lënë asfaltimi i rrugës Herticë - Surdull, projekt i cili së paku në këtë legjislacion ka qenë në prioritet dhe kanë qenë të parapara mjetet përkatëse por i njëjti nuk është realizuar, përkundër faktit se është brez kufitar dhe afro 40 familje për shkak të rrugës janë në gjendje të vështirë, qytetarë të cilët edhe më parë kanë ardhur në debate buxhetore dhe e kanë shtruar këtë problem, andaj do

të ishte mirë që nëse nuk ka mundësi në vitin 2016 së paku ky projekt të realizohet në vitin 2017.

Gjithashtu e ndaj mendimin me kolegun Haki Rudarin lidhur me atë se ky dokument do duhej të ishte më i detajizuar, përkatësisht të konkretizohen rrugët të cilat do të asfaltohen si dhe urat të cilat do të ndërtohen.

z. Kumrie Hoti, theksoi, në Kornizën afatmesme 2015 – 2017, përkatësisht në vitin 2016 ka qenë në prioritete rruga e fshatit Revuç në shumë prej 80.000 € dhe jam e interesuar të di përse ky projekt është bartur në vitin 2018 në shumë prej 60.000 € duke e ditur se projektin zbatues e kanë siguruar qytetarët.

z. Kadri Avdiu, theksoi, për asfaltimin e rrugës Batllavë – Dyz janë paraparë 90.000 €, më interesin se a janë të mjaftueshme këto mjete apo jo.

Në fshatin Bellopojë, për vitet 2016 – 2018, nuk është paraparë asnjë cent investime, andaj pyetja ime është se a mendoni që janë realizuar komplet projektet apo përse është bërë një anashkalim i tillë.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, theksoi, pozicioni i hartimit të projekteve nuk ka të bëjë me projekte elementare infrastrukturore përkatësisht asfaltimin e rrugëve, kanalizimeve dhe rrjeteve të ujësjellësit por ka të bëjë me planet rregulluese, Zona qendër dhe atë për pjesën veriore dhe pjesën jugore.

Rregullimi dhe pastrimi i shtratit të lumit Llap ka të bëjë me pjesën në qytet.

Sa i përket specifikimit të projekteve në fshatra, po ndalem te fshati Shajkoc që u përmend gjatë diskutimit, kohë më parë është publikuar tenderi për rrugën e lagjes Sinani por nuk është paraqitur asnjë operator, mirëpo janë shtruar edhe tri kërkesa nga ky fshat dhe në ndërkohë do të analizohet se cilat rrugë janë më me prioritet, kjo është arsyeja, jo vetëm në këtë rast por për shumë raste që nuk janë konkretizuar projektet.

Për çështjen e fshatit Bellopojë, që nuk janë përfshirë projekte, nuk jam në dijeni si është përvjedhtë kjo dhe mund të them se ky është një gabim teknik.

z. Kadri Avdiu, theksoi, rruga në fshatin Bellopojë është shkatërruar gjatë punimeve në burgun e sigurisë së lartë në Gërdoc dhe ka qenë një marrëveshje gojore me Ministrin e Ministrisë së Infrastrukturës që ajo rrugë të riparohet prej disa mjeteve që i kishin tepruar Ministrinë e Drejtësisë, mirëpo kjo nuk ka ndodhë.

z. Durim Salihu, theksoi, për momentin nuk mund të realizohet projekti për asfaltimin e rrugës Herticë – Surdull, për shkak të kostos së lartë që minimumi është 500.000 €, por jam i mendimit se kjo rrugë si kod duhet të mbetet gjithherë duke shpresuar në Nivelin qendror që eventualisht ndoshta do të participojë në realizimin e atij projekti. Rruga Batllavë – Dyz është në gjendje shumë të keqe dhe në vija të trasha është paraparë shuma përkatëse që sipas meje kostoja do të jetë plus ose minus 10%. Asfaltimi i rrugës në fshatin Revuç është bartë prej vitit 2016 në vitin 2018 ngase është zvogëluar granti qeveritar për investime kapitale por edhe arsye tjetër është se ne kemi qenë të detyruar që një pjesë të projekteve t'i bartim në brezin kufitar.

z. Naim Çunaku, theksoi, fillimisht vërejtja ime është për Shërbimin profesional që nuk e ka sjellë ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur me qytetarë, jo me qëllimin që të kritikoj por për atë se ne para atyre qytetarëve kemi marr obligim që projektet e propozuara të tyre t'i

shqyrtojmë dhe duke e parë arsyeshmërinë si dhe mundësitë buxhetore mundësisht të përfshihen në këtë dokument.

Lidhur me pozicionin, hartimi i projekteve, drejtori i Drejtorisë përkatëse i dha sqarimet, mirëpo unë edhe vitin e kaluar e kam thënë dhe sërish po e them mendimin tim se do duhej të kemi një kategori buxhetore të veçantë për projektet e investimeve kapitale, ngase ka mjedise që kanë nevojë për realizimin e ndonjë projekti, mirëpo për shkak të pamundësisë financiare për sigurimin e projektit zbatues apo ndonjë arsyeje tjetër projektet po mbeten pa u realizuar, andaj kërkoj që kjo çështje të konsiderohet si propozim i imi.

Në mbledhjen e cekur me qytetarë, përshtypje më kanë lënë në veçanti propozimi i përfaqësuesit të fshatit Shajkoc i cili tha se në fshatin Shajkoc i kemi kryer projektet e infrastrukturës por na ka mbetur vetëm ndriçimi publik, pastaj përfaqësuesi i fshatit Metehi ka thënë, ne kërkojmë që në vitin 2016 të shtohet shtresa e dytë e asfaltit, e kjo nënkupton se çështjet tjera i kanë kryer.

Gjithashtu u përmend edhe problemi i Vrellës së Revuçit, projekt nga mandati i kaluar i Kuvendit, për të cilin mund të themi se është gjysmë i dështuar, këtë çështje e ngriti një zyrtar i Komunës që gjendjen e din më mirë se unë, por ka pasë edhe lagje që janë interesuar për atë projekt.

Problem numër një në Komunën e Podujevës që e kam parë edhe te OJQ – të, është çështja e ambientit të degraduar e në veçanti gjendja e lumenjve, andaj kisha dëshiruar që kjo çështje në Komunën tonë të zë një vend meritore dhe të bëhen përpjekje për trajtimin mundësisht sa më të mirë të ujërave të zeza.

z. Durim Salihu, theksoi, në mbledhjen e këtij Komiteti të mbajtur me qytetarë janë shtruar mbi njëzetë kërkesa dhe mund të them se shumica e atyre kërkesave janë të përfshira në Kornizën Afatmesme Buxhetore.

z. Kumrie Hoti, theksoi, nuk jam e kënaqur me përgjigjen lidhur me rrugën në fshatin Revuç, nuk jam kundër asaj që të investohet në zonën kufitare, mirëpo rruga në fshatin Revuç është në gjendje shumë të keqe, andaj propozoj që të hiqet nga prioritetet e vitit 2018 dhe të rikthehet në prioritetet e vitit 2016.

z. Faik Muçiqi, theksoi, propozimet e paraqitura në debatin e Komitetit për Politikë dhe Financa me qytetarë, kryesisht janë të përfshira në këtë dokument por sigurish që janë të përfshira edhe kërkesat e paraqitura më herët. Jeni në dijeni se projektet e propozuara mund të ndryshohen mbi bazën e propozimeve të juaja por edhe mbi bazën e propozimeve të paraqitura në mbledhje të Kuvendit.

Specifikimi projekteve nuk është bërë për shumë arsye, shembull ndërtimi i kanalizimeve që kryesisht është në disa lagje të qytetit ku ose për shkak të asfaltimit të rrugëve ose ndonjë pune shtesë nuk janë specifikuar në buxhetin e përgjithshëm, mirëpo nëse dëshironi kjo mund të bëhet deri në shtator kur edhe miratohet projektbuxheti.

Ndërtimi i kanalizimeve në rrugë regjionale është paraparë të bëhet në fshatrat Dobërdol, Zakut, Metehi, Dumnicë etj.

Rindërtimi i urave është kod i përgjithshëm i cili kryesisht përfshinë rindërtimin e urave të vogla me kosto të ulët dhe atë në lagje të ndryshme, ura të cilat janë dëmtuar nga vërshimet ose nga vjetërsia.

Nga debati i Komitetit për Politikë dhe Financa me qytetarë në këtë dokument janë përfshirë tri kërkesa dhe atë ndërtimi i kanalizimeve në fshatrat Lladoc, Herticë dhe Siboc.

z. Fidan Rekalii, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK – së, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore për periudhën 2016 – 2018 është kornizë e një rëndësie të veçantë e cila ndikon në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës tonë dhe e mbështesim këtë dokument ngase është një kornizë buxhetore e cila ngërthen në vete projekte të larmishme që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

z. Islam Revuçi, theksoi, në fshatra thuajse ka përfunduar çështja e ndërtimit të kanalizimit, andaj është mirë që tani të fokusohemi në qytet ngase ka mjedise që janë në gjendje të rënd sa i përket funksionimit të kanalizimeve të cilat janë të amortizuara, shembull mund ta marrim ndërtesën kolektive montazh në rrugën “ 20 Qershori “, në bodrumin e të cilës grumbullohen ujëra të shumta duke përfshirë edhe ujëra të zeza të cilat kundërmojnë dhe e vështirësojnë jetën e banuesve të asaj ndërtese. Përndryshe mbi bazën e vlerësimeve të disa komisioneve është konstatuar se ndërtesa e cekur nuk i plotëson kushtet për banim, andaj do duhej të filloj procedura për rrënimin e atij objekti dhe ndërtimin e objektit të ri sipas Planit Rregullues Urban.

z. Faik Muçiqi, theksoi, jam i informuar se në bodrumin e ndërtesës të cilin e përmendi parafolësi grumbullohen ujërat e zeza për shkak të ndonjë rrjedhjeje e cila nuk dihet nga buron, bodrumi është zbrazur disa herë nga uji mirëpo kjo nuk është zgjidhje por zgjidhja është rregullimi i brendshëm i rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit.

Pas votimit u konstatua se Korniza Afatmesme Buxhetore, njëzëri Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 14.20’

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-59692
Podujevë,
25 qershor 2015**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**